

Konferenca TeachBeyond Shqipëri

Me gëzim presim të jemi së bashku në Konferencën e 6-të vjetore të mësuesëve me temë:

Edukimi që ndërton mençurinë.

Biografia e Prezantueses - Mollie Shaw

M.Ed, PCET, CDT



Mollie Shaw ka dhënë mësim në shkolla publike dhe private për njëmbëdhjetë vjet. Ajo ka edukuar në kushte shtëpie (homeschool) gjashtë fëmijët e saj për dy dekada dhe ka themeluar programe hibride mësimore në disa shtete të SHBA-së, duke u bërë kështu një lidere e njohur në edukimin klasik të krishterë. Që nga viti 2016, kompania e saj **Trinity Harbor Education** ka ofruar trajnime profesionale për mësues, terapi edukative dhe një gamë të gjerë shërbimesh mbështetëse për shkollat. Pasioni i saj është të pajisë mësuesit të arrijnë ekselencë në klasë.

Mollie ka një **Master në Edukimin e Nxënësve Ekselent**, me specializim në **Terapi Arsimore**, dhe është terapiste e certifikuar nga **Instituti Kombëtar i Zhvillimit Arsimor** në Norfolk, Virginia. Ajo jeton në Teksas së bashku me bashkëshortin e saj. Aktualisht është pjesërisht në pension dhe i pëlqen të kalojë kohë me kuajt e saj, si dhe të shërbejë në misionet e **Spark Worldwide**, duke marrë pjesë në ungjillizime përmes kishës së saj

Workshop 1

Matematika – Gjuha e Zotit në Natyrë: Zhvillimi i Habisë dhe Gëzimit përmes Metodave Konceptuale

Fokusi:

Pajisja e mësuesve për të parë matematikën si strategji mendore që pasqyrojnë strukturën dhe modelet e perceptimit të Zotit

Përshkrimi:

Zoti e krijoi botën të mbushur me modele dhe krijoi edhe mendjet tona për t'i perceptuar ato. Ky workshop prezanton metoda për të shpjeguar matematikën në mënyrë konceptuale, përmes ushtrimeve, lojërave, rimave dhe demonstrimeve praktike që forcojnë perceptimin joverbal të matematikës si marrëdhënie sasiore, hapësinore, kohore dhe pozicionale.

Aftësitë bazike të perceptimit dhe arsyetimit hapësinor u mundësojnë nxënësve të zhvillojnë në mënyrë të ndërthurur dhe logjike konceptet e vendit, vlerës, kuptimit numerik dhe mendimit me bazë dhjetore. Fëmijët që mësojnë matematikën konceptualisht përdorin strategji të shumta për zgjidhjen e problemeve.

Mësuesit do të marrin pjesë në demonstrime interaktive të metodave të veçanta matematikore, ndërsa nxënësit do ta kuptojnë matematikën si modele dhe si pjesë e bukurisë së krijimit të Zotit.

Workshop 2

Zhvillimi i Botëkuptimit Biblik përmes Letërsisë Klasike

Fokusi:

Përgatitja e mësuesve që të udhëheqin nxënësit në analizë tekstuale, biblike dhe kulturore gjatë studimit të letërsisë botërore, duke përfshirë metodat Sokratike dhe Dialektike.

Përshkrimi:

Si mund të zhvillojë një mësues i talentuar një botëkuptim biblik ndërsa shpjegon letërsi botërore laike? Ky workshop do të prezantojë përdorimin e pyetjeve të eseve që i nxisin nxënësit të analizojnë letërsinë nga perspektiva tekstuale, biblike dhe kulturore. Mësuesit do të mësojnë një metodë të quajtur **Ditari Dialektik**, një metodë e strukturuar ku nxënësit mbledhin pyetje dhe reflektime mbi tekstin. Ata gjithashtu do të marrin një përmbledhje se si të përdorin **Metodën Sokratike** në diskutime tryezash të rrumbullakëta duke u bazuar në ditarët e tyre. Këto metoda të fuqishme e bëjnë letërsinë personale dhe domethënëse për nxënësit, ndërsa leximi aktiv, analiza e nivelit të lartë, përmbledhja dhe vlerësimi bëhen aktivitete të natyrshme gjatë diskutimeve në klasë.